



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DENISA ÇELA
ADRESA NJESIA BASHKIAKE NR. 10,
RR. RESHIT ÇOLLAKU, GODINA
NR.7, APARTAMENTI NR.91, HYRJA
NR.7
TEL: 0694058103

KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT

Nr. repertori: 2908

Nr. koleksioni: 503

Tirane më 13/08/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021053750056711255



A2021053750056711255

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"PROCEDURE" SH.P.K**

Sot, më datë 13 gusht 2021 (dymije e njetete e nje), para meje Notere DENISA ÇELA, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA BASHKIAKE NR. 10, RR. RESHIT ÇOLLAKU, GODINA NR.7, APARTAMENTI NR.91, HYRJA NR.7, u paraqit personalisht:

ORTAKET THEMELUES :

ORTAK/ET:

Paola Dinaku, atësia Velo, amësia Elida, shtetase Shqiptare, lindur në Elbasan dhe banuese në ELBASAN, me adresë Mustafa Skuqi 00910378; Nd. 18; H. 1; Elbasan; Elbasan; 3001; Elbasan, lindur më 24/03/1994, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BC0875212 dhe nr. personal J45324070R, .

ORTAK/ET:

Liri Çareri, atësia Adem, amësia Razije, shtetase Shqiptare, lindur në Tërbisht, Peshkopi dhe banuese në TIRANË, me adresë Khanfize Keko; Nd. 83; H. 13; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 28/03/1969, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033885845 dhe nr. personal G95328191N,

Baza Ligjore: Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Neni 62, pika 1, gërma "I" të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

Rrethanat për hartimin e aktit noterial:

Personat me identitetin e mësipërm shprehën vullnetin e tyre të lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të krijohet dhe vepron sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, si dhe do të referohet për mbarëvajtjen e saj në Aktin e Themelimit dhe Statutit të krijuar nëpërmjet këtij akti.

Në zbatim të gërmës "I" të pikës 1 të nenit 62 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", ku parashikohet: Kompetencat e noterit/es: l) përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërive tregtare", unë noterja marr pjesë gjatë hartimit të Aktit të Themelimit dhe të Statutit të shoqërisë.

Për sa më sipër, u hartua Akti i Themelimit dhe Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "PROCEDURE" sh.p.k, nga unë noterja, në prezencë të ortakëve të shoqërisë, bazuar në vullnetin e lirë e të plotë të tyre, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare. Pasi u lexua qartazi dhe u kuptua rëndësia dhe efektet ligjore, nënshkruhet Akti i Themelimit dhe Statuti i shoqërisë "PROCEDURE" sh.p.k me adrese ne Tirane, Rruga "Kongresi i Manastirit", Pallati 419/11, Kati 2-te, Apartamenti 4, me Administratore Znj. Liri Çareri, në praninë time. Unë noterja, e vërtetoj sipas ligjit.



TITULLI I

EMRI I SHOQËRISË - REGJIMI JURIDIK - SELIA - KOHEZGJATJA

NENI 1 - Emri i Shoqërisë

1.1 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, është krijuar Shoqëria "PROCEDURE" sh.p.k, ne vijim referuar si "Shoqëria".

1.2 Shoqëria ka logon dhe vulen e saj zyrtare.



Fq. 1



A2021053750056711255

NENI 2 - Regjimi Juridik i Shoqërisë

2.1 "PROCEDURE" sh.p.k është një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj është i organizuar sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil në Republikën e Shqipërisë.

2.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë regjimin e saj juridik, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe dispozitat e Statutit të saj.

2.4 Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

NENI 3 - Selia

3.1 Shoqëria ka selinë e saj në adresën: Tirane, Rruga "Kongresi i Manastirit", Pallati 419/11, Kati 2-te, Apartamenti 4.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë, filiale dhe / ose zyra përfaqësimi brenda Shqipërisë dhe / ose jashtë vendit, ose të krijojë shoqëri të tjera me Partnere apo Aksionare pjesëmarrës.

NENI 4 - Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortaket e shoqërisë mund të vendosin të kufizojnë kohezgjatjen e aktivitetit me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

TITULLI II

OBJEKTI

NENI 5 - Objekti

5.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në veprimtaritë e mëposhtme:


1. Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është shërbime në fushën e platformave software, krijim dhe mirëmbajtje software, trajnim dhe specializim personeli në fushën dixhitale, software etj.
2. Marketing dixhital dhe shërbime të tjera që kanë të bëjnë me internetin. Çdo shërbim tjetër që ligji i të drejtës tregëtare e quan të arsyeshme. Shitjet dhe tregtimi i zgjidhjeve softuerike;
3. Konsulencë organizative;
4. Trajnim;
5. E-commerce;
6. Zhvillim software në të gjitha platformat për web, desktop, mobile etj duke përfshirë proceset e analizës, dizajn, planifikim, implementim, mirëmbajtje. Zhvillim ose ndërmjetësim në trajnime dhe kurse profesionale në fushën e zhvillimit të software dhe TI (Tëknologji të Informacionit). Konsulencë në fushën e zhvillimit software në platforma të ndryshme. Disenjim software-i. Këtu përfshihet analiza e kërkesave të sistemit software, projektimi i arkitektures dhe projektimi i detajuar i sistemit software; Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software. Këtu përfshihet programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i të gjithë komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve, modifikimet (pas momentit që software-i është vendosur në operim), mirëmbajtja e të gjithë komponenteve, suportit i sistemit si një teresi komponentesh, që, në funksionimin e tyre, realizojnë qëllimin e zgjidhjes informatike; Testim software. Këtu përfshihet testimi i funksionalitetëve, të ngarkesës në punë, të performancës, të pranimit, të disponueshmërisë dhe të sigurisë së sistemit software; Disenjim dhe zhvillim sistemesh të komunikimit. Këtu përfshihet analiza, planifikimi, projektimi, zbatimi, vendosja në punë dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit të rrjetëve të pajisjeve informatike (LAN/ WAN/ WLAN/ MAN/ SAN/ CAN); Disenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë. Këtu 2 përfshihet analiza e kërkesave të sigurisë së klientit, projektimi i arkitektures, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja në punë, testimet e sigurisë dhe mirëmbajtja përkatëse; Zhvillim sistemesh migrimi. Këtu përfshihet transferimi i të dhënave dhe infrastruktures përkatëse nga një teknologji e vjetër në një teknologji të re; Përmirësim/upgrade sistemesh informatike; Operimi, menaxhimi, suportit i përdorimit, trajnimit dhe auditimit teknik/informatik për sistemet software;

Lae *Peroljubaj*
Eq. 2



A2021053750056711255

7. Agjensi publike brenda dhe jashte vendit; Rekrutim stafi per te trete; Interior design, Graphic design, Event design, Furniture design, projektim plus zbatim; Arkitekture; Software development; Web development; Nderitim; Trajnime e kurse te ndryshme; Tregti materialesh; Trajnim per pjesen e kodimit (software inqining); ReKrutim; Prokurim stafi per te trete; Marketing; Konsulence ne zhvillim softweresh; Arkitekture/Design/zbatim;
8. Do te operoje ne sektorin e telekomunikacionit duke kryer cdo lloj aktiviteti nepermjet telefonise per llogari te saj dhe/ose per llogari te te treteve ne territorin e Shqiperise si dhe ne cdo vend tjetet qe ka lidhje me Republiken e Shqiperise ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Te kryeje te gjitha aktivitetet telefonike, sherbime te konsulences dhe marketingut, sekretari telefonike, sondazhe, mesazhe promocionale. Kerkime te marketingut online. Aktivitet ne fushen e marketingut ne Web. Kryerja e hulumtimeve te marketingut. Aktivitete telefonike, thirrje ne web, aktivitete ne fushen e dhenies se sherbimeve te ndryshme online. Analizimi i te dhenave dhe zhvillimi i strategjiive te ndryshme te marketingut. Aktivitet ne fushen e organizimit te seminareve, takime, konferenca, organizime te pergjithshme dhe aktiviteteve e promovimit te imazhit. Per 2 me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjetet i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.
9. Projektim Arkitektonik: objekte civile, industriale, spitalore, turistike, porte, aeroporte vepra arti ne infrastrukture, kulti, administrative, interieri, paisazhi, hoteleri, siperfaqe te gjelberta, parqe, lulishte, restaurim i monumenteve te kultures. Projekte Adaptimi. Dizenjim grafik, Animacion, Modelim, renderizim. Perpunim grafik projektesh. Perpunim arkitektonik planimetrish, modele 3d me materiale te ndryshme. -Projektme Masterplane-Smdime e plane rajonale Urbanistike, plane rregulluese te pergjithshme per qendra te banuara dhe qytete si dhe smdime pjesore Urbanistike si dhe plane te detajuara vendore PDV.- Projektim Konstruktiv: objekte civile, industriale, spitalore, turistike, vepra arti ne infrastrukture, kulte, administrative, perpunim konstruktiv, projektim objektesh me shkalle te larte veshtiresie beton arme, metalike troje e shpate me qendrueshmeri te larte. -Projektim dhe zbatim te punimeve te ndertimit, rikonstruksione, mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi dhe montimi ne godina civile, industriale, bujqesore, turistike, shoqerore, veprave ujore, kanalizime te ndryshme, rruge ura e vepra arti, punime komunale dhe te mjedisit, si dhe punime te te gjitha llojeve ne fushen e 2 ndertimit e montimit. Ne drejtim te projektimit, ndertimit dhe mirembjates se sistemeve te objekteve sportive, interiere, paisazhi, siperfaqe te gjelberta, lulishte dhe parqe. -Projektim dhe zbatim te punimeve te ndertimit te sistemeve te ngrohjes dhe ftohjes, ventilimit dhe klimatizimit. Eksport-import dhe tregtim me shumice e pakice te te gjitha llojeve te materialeve dhe pajisjeve te ndertimit, hidrosanitare, elektrike, te malkave te ndryshem industriale dhe mallra te te gjitha llojeve. Veprimtari e lidhur me asistencen teknike te te gjitha sherbimeve te permendura me siper, etj. -Vleresimin e pasurive te paluajtshme per ndertesate dhe toke truall. Hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditimin mjedisor, per hartimin e ekspertizave per problemet mjedisore dhe thirrjen si ekspert per te vleresuar nje raport vleresimi te ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi. -Studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji si edhe hartimin e akteve te ekspertizes teknike per zjarret e rena. Projektim -zbatim konstruktiv. Projektim -zbatim te objekteve te ndryshme me konstruksione metalike. - Projektim dhe rilevime per bazamente gjeodezike, projektme topografike dhe hartografike dhe fotogrametike. Studime gjeologo - inxhinierik i truallit per te gjitha llojet e objekteve. Smdime te Sizmiologjise inxhinierike.-Projektim instalator: Instalime hidrosanitare. Linja e rrjeta elektrike - telefonike -radiotelefoni - citofoni -sistem alarmi • televiziv etj, perobjekte civile, industriale, turistike. Sisteme komplekse te telekomunikacionit, Sisteme te furnizimit me gaz.-Projekrim veprash hidraulike: Diga - galeri - tunele hidraulike. Furnizim me uje - kolektore shkarkimi. Ujesjelles kanalizime urbane - rurale. Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditese -diga deri 10m - damba. Vepra te trajtimit te ujit. Vepra hidroteknike, marrjeuji, shkarkimi-kulla ekuilibri porte- pontile, Vepra naftesjelles - gazsjelles - vajsjelles etj. - Projektimin e impjanteve te prodhimit dhe shperndarjes se energjise ne: Centrale hidraulike (elektrik, primare, sekondare). Centrale termike (primare, sekondare). Impiante te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike - diellore - era etj. Nen stacione elektrike, primarsekondar - linja te tensionit te


Fq. 3



A2021053750056711255

- larte. Kabina elektrike te rrethit shperndares - linja te tensionit te ulet - te mesem. -Projektim Sinjalistike rrugore ne: rruge lokale, rruge urbane dytesor edhe rruge interurbane dytesore. Sinjalistike ne autostrada, rruge urbane kryesore dhe rrugeinterurbane kryesore dhe ne degezime me hekurudhen.
10. Import-export, tregtine me shumice dhe pakice, kryerjen dhe marrjen pjese ne te gjitha aktivitetet qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar si dhe cdo aktivitet tjetër te nevojshem per realizimin e qellimeve te shoqerise perfshire dhe aktivitetin e ofrimit te sherbimeve, tregtimin, importin dhe eksportin e mallrave dhe sherbimeve. Projektimin, instalimin, operimin dhe mirembajtjen e sistemeve te , prodhimit, prezantimit, transmetimit e monitorimit audio/vizual, TV. Projektimin, instalimim, operimim dhe mirembajtjen e sistemeve te komunikimit WebConference, E-Publishing, E-Learnig, EComunication, VOIP, WEB Pages, DataBase, Digital Asset Management, Digital Logging, Monitoring e Analyzing etj. Konsulencen, trainime dhe sherbime ne fushen audio/vizive, telefoni, IT, multimediale, internet, WEB TV, Radio, Produksion TV, Transmetim Satelitor, Tokesor, Kabllor, TCP-IP, Analog e Digital. Import-export, tregtine me shumice dhe pakice te materialeve dhe paisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe aksesoreve te tyre, projektimin, instalimin, mirembajtjen e sistemeve elektrike dhe elektronike, trajnim personeli etj. Sherbime ne assemblimin e pjeseve kompjuterike, te pajisjeve audio dhe video bashke 2 me programet perkatese, te moduleve te programeve kompjuterike ne programe te plota. Blerjen, marrjen e dhenien me qera apo ne pergjithesi, shfrytezimin e pasurive te paluajtshme, perdorimin e paisjeve te shoqerise per prodhimin e artikujve te Cdo lloji dhe dhenien e garancive personave te trete. Realizimin e kontratave mareveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo i formave te tjera te lejuara nga legjislacioni shqiptar me persona fizike dhe juridike shqiptare apo te huaj per te realizuar operacione industriale tregtare dhe veprimtari te ndryshme qe jane te nevojshme dhe ne interes te shoqerise. Furnizim, integrim dhe realizim te pajisjeve, teknologjive, impianteve dhe sistemeve: elektrike, elektronike, informatike, mekanike, elektro-mekanike, akustike, te interierit etj. per objekte dhe ambjente kulturele, sportive, argetuese struktura publike dhe private. Sherbime, operime dhe dhenie me qira te teknologjive dhe pajisjeve per realizimin e eventeve kuturore, sportive argetuese, promocionale apo te cdo lloji tjetër

Gjithashtu shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatueshem ne Republiken e Shqiperise.

Sipas legjislacionit ne fuqi, shoqeria ne menyre qe te arrije objektivat e saj mund te kryeje aktivitete te konsideruara te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise.

Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjetër i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji ne fuqi, qe sjell perfitime dhe eshte ne interes te Shoqerise.

TITULLI III

KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 6 – Kapitali i Shoqerise

6.1 Kapitali i shoqerise eshte ne vleren **10,000 Lek (dhjete mije Lek) i perbere nga dy kuota.**

Kapitali i shoqerise do te paguhet plotesisht nga ortakut themelues si me poshte vijon:

a) **Znj. Liri Çareri**, nenshkruese e 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 5000 Lek (pese mije Lek);

b) **Znj. Paola Dinaku**, nenshkruese e 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 5000 Lek (pese mije Lek);

Neni 7 - Transferimi i kuotave

7.1 Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet se drejtes se parablerjes ne favor te ortakëve te tjere te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin 7.2 deri ne nenin 7.6 me poshte.



A2021053750056711255

7.2 Në rast se një ortak "Ofruesi" kërkon të shesë dhe/ose të transferojë disa ose të gjitha kuotat e tij, Ortaket e mbetur do të kenë të drejtën e parablloqes në lidhje me kuotën që ofrohen për transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve të mëposhtme:

(a) Ofruesi do të dërgojë fillimisht ortakeve të mbetur një njoftim me shkrim i cili përcakton përqindjen e kuotes së ofruar, cmimin dhe kushtet e tjera të transferimit, duke ftuar se pari Ortaket e mbetur të blejnë aksionet e ofruara;

(b) Ortaket e mbetur do të kenë të drejtën të blejnë kuotat e ofruara përpjestimisht dhe sipas kushteve të ofertes, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një afati prej tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së njoftimit të Ofruesit.

7.3 Në rast se më shumë se një prej Ortakeve të mbetur dëshirojnë të blejnë kuotën e ofruar, secili prej këtyre ortakeve të mbetur do të ketë të drejtën të blejë kuotën e ofruar përpjestimisht sipas përqindjeve që zoterojnë në Shoqeri, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit brenda një periudhe prej tridhjetë (30) ditësh nga marrja e njoftimit sipas se cilit secili prej tyre dëshiron të blejë kuotën e ofruar.

7.4 Në rast se asnjë nga ortakët e mbetur nuk dëshiron të blejë kuotën e ofruar dhe/ose kanë refuzuar të blejnë kuotën e ofruar dhe/ose nuk janë përgjigjur brenda tridhjetë ditëve nga marrja e këtij njoftimi, Ofruesi do të ketë të drejtën të transferojë Kuotat e ofruara një pale të tretë me të njetin cmim që i është ofruar ortakeve të mbetur (sipas kushteve të ofertes fillestare). Nëse ky kusht nuk është përmbushur, Marrveshja për Shitjen e Kuotave me paletë të treta do të jetë e pavlefshme.

7.5 Në rast se ndonjë ose të gjithë ortakët e shoqërisë blen/blejnë kuotat e ofruara sipas kushteve të ofertes, sic përcaktohet me sipër, ky transferim do të kryhet sipas kushteve të ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara me sipër nuk do të zbatohen në rast transferimi të kuotave nga një ortak tek një shoqeri e cila ndodhet nën kontrollin e këtij ortaku ose në rast transferimi nga një ortak tek një pasardhës ose pasardhës i drejtpërdrejtë i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e nënve 7.1- 7.6, nuk do të zbatohen në rast transferimi të bere në favor të një ose disa ortakeve të tjera. Megjithatë, në këtë rast transferimi duhet të komunikohet fillimisht të gjithë ortakeve. Të gjitha njoftimet sipas këtij neni duhet të dërgohen edhe Shoqërisë.

Neni 8 - Rritja e Kapitalit

8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Në rast të një rritje të kapitalit, ortakët kanë të drejtë të nënshkrimit të kuotave nëpërmjet kontributit në natyrë ose në të holla, në proporcion me përqindjen që zotojnë në kapitalin e shoqërisë.

8.3 Nëse ndonjë nga ortakët refuzojë të drejtën nënshkrimit, kapitali mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, ortakët e tjerë mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për nënshkrimin e kapitalit në proporcion me përqindjen që zotojnë në kapitalin e shoqërisë.

Neni 9 - Zvogelimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e përgjithshme mund të zvogelojë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me kuorumin e përcaktuar në nenin 12 të këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali nuk mund të reduktohet nën vlerën minimale të përcaktuar me ligj.

9.2 Ortaket përballen me uljen e kapitalit të shoqërisë në proporcion me kuotat e zotëruara nga secili prej tyre në kompani.

Neni 10 - Certifikata e pjesëmarrjes

10.1 Secili nga ortakët gëzon të drejtën e një certifikate në lidhje me përqindjen në pjesën që gëzon në kapitalin e shoqërisë. Shoqëria nuk është e detyruar të leshojë me shumë se një certifikatë për kuotat e mbajtura së bashku nga disa ortakë dhe shpërndarja e certifikatës për përfaqësuesit e përbashkët e anëtarëve do të konsiderohet e dhënë në interes të të gjithë ortakeve, në përputhje me dispozitat e ligjit.

TITULLI IV

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 11 - Organet e Shoqërisë

- 11.1 Organet e Shoqerise jane:
1) Asambleja e Pergjithshme;
2) Administratori / et.



A2021053750056711255

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

1) Asambleja e Pergjithshme

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithë Ortaket e Shoqerise.

11.2 Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe te votoje ne baze te kuotave qe zoteron.

11.3 Ortaku mund te perfaqesohet nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht Ortake, me ane te nje Prokure te Posacme. Ne çdo rast, kjo Prokure e Posacme mund te jepet vetem per nje Mbledhje te caktuar te Asamblese se Pergjithshme, dhe do te jete e vlefshme edhe per mbledhjet pasardhese me te njejtin rend dite. Administratorët nuk mund te perfaqesojne Ortakun ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

11.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mblidhet ne nje vend te ndryshem nga selia e Shoqerise, ne Republiken e Shqiperise ose jashte vendit.

11.5 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave te Shoqerise ose nese kerkohet nga legjislacioni ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret edhe nga cdo Ortak qe zoteron te pakten 10% (dhjete per qind) te pjeses se kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda javes se fundit te muajit Maj, ne menyre qe te diskutoje, te shqyrtoje dhe te miratoje bilancin vjetor te vitit te kaluar fiskal. Mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme, do te mbahet brenda tre muajve nga dita e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar per te diskutuar planin e biznesit dhe çeshtje te tjera.

11.6 Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme do te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, dhe do te dergohet ne adresat e Ortakeve te shoqerise te regjistruara ne Regjistrin e Ortakeve, ose me poste elektronike ne adresat e Ortakeve, ose me poste tek Ortaket se paku 21 (njetzet e nje) dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

11.7 Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen ne rendin e dites dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyra e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.

11.8 Asambleja e Pergjithshme do te konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nese nuk ka ndjekur te gjitha formalitetet e thirrjes, nese te gjithë Ortaket qe perfaqesojne pjesen e tere kapitalit te shoqerise jane te pranishem ne mbledhje apo te perfaqesuar nga nje perfaqesues me prokure te posacme, dhe shprehen dakort per te zhvilluar mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullsive ne thirrjen e saj.

11.9 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e njerezve ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet permes telekonferences apo videokonferences, ose mjete te tjera te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te mund te identifikohen dhe t'i jepet mundesia per te marre pjese ne diskutimet dhe per te marre pjese ne to.

11.10 Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emerohet nga radhet e Ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje. Nese prezenca e nje noteri publik nuk eshte e nevojshme, Asambleja e Pergjithshme do te emeroje nje sekretar, i cili nuk duhet te jete domosdoshmerisht nje nga Ortaket.

11.11 Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat e posacme dhe rregullsine e tyre, te drejten e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, si dhe per te percaktuar nese Mbledhja eshte thirrur rregullisht dhe nese kuorumi i nevojshem per marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per te percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

11.12 Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe ka fituar Kuotat e Ortakeve te tjere me ane te nje procesi ligjor dhe zoteron tere kapitalin e shoqerise, vendimet e Ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen.



A2021053750056711255

NENI 12- Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

12.1 Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjetë perqind) te Kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30(tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

12.2 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) percaktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat e permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (f) monitormin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;
- (h) cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga ligi apo statuti.

12.3 Ne rast vendimesh te jashtezakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjetë perqind) te kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30(tridhjetë) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e jashtezakonshme merren me voten pro te te pakten $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) e ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

12.4 Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) ndryshimi apo plotesimi i Statutit te Shoqerise;
- (b) zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit
- (c) shperndarjen e fitimeve vjetore nepermjet dividenteve dhe akordimin e aksioneve ne vend te dividenteve;
- (d) riorganizimin, shperndarjen, transformimin, bashkimin, shkriren, ndarjen, likuidimin apo prishjen e shoqerise si edhe riorganizimin e shoqerise ne nje forme tjeter;
- (e) ndermarrjen e cdo veprimi i cili pitet ne menyre te arsyeshme se do te coje ne likuidimin e shoqerise;
- (f) hapjen e nje dege, blerjen apo shitjen e nje dege me ose pa emer;
- (g) marrjen persiper te cdo detyrimi me nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aktiveve totale te shoqerise sic rezulton nga pasqyrat e fundit financiare te audituara;


NENI 13 – Administratori

13.1 Asambleja e Pergjithshme do te caktojë nje (1) personi fizik si Administrator te shoqerise, i cili mund te jete ortak ose jo dhe qe do te jete pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

Administratori ushtron keto detyra:

- (a) menaxhon shoqerine duke zbatuar politikat sic percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (b) sigurohet qe te mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;
- (c) Mban dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe ja paraqet ate Asamblese se Pergjithshme per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (d) krijon nje sistem paralajmerimi te hershem ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;
- (e) paraqet te dhenat e shoqerise per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas rastit;
- (f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per punen e Shoqerise;
- (g) cdo detyre tjeter sic percaktohet me ligj ose Statut.

13.2 Administratori emerohet per nje periudhe deri ne 5 (pese) vite dhe me te drejte rizgjedhjeje. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



Fq. 7



A2021053750056711255

13.3 Shoqëria merr angazhime me nenshkrimin e vetem të administratorit, sipas kufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi dhe në këtë Statut dhe Akt Themelimi.

13.4 Administratori i shoqërisë ka të drejtën dhe detyrimin për të përfaqësuar Shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet.

13.5 Asambleja e Përgjithshme emeron si Administrator të shoqërisë, Liri Çareri, atësia Adem, amësia Razije, shtetase Shqiptare, lindur në Tërbisht, Përkopi dhe banorë në TIRANË, me adresë Xhanfize Keko; Nd. 83; H. 13; Ap. 26; Njësia Administrative Nr. 4; Njësia Bashkiake Nr. 4; 1005; Tiranë, lindur më 28/03/1969, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 033885845 dhe ID personal G95328191N, **per nje afat 5 (pese) vjecar me te drejte rizgjedhje. Nenshkrimi I Administratorit**

TITULLI V

VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

NENI 14 - Viti Financiar

14.1 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

14.2 Perjashtimisht viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) dhe përfundon me 31 Dhjetor të atij viti.

NENI 15 – Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve

15.1 Përmes vendimit të asamblesë së përgjithshme shoqëria shpërndan dividentin në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve, nëse:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimin e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të paguar detyrimet që duhet të jenë të pagueshme brenda 12 muajsh.

15.2 Kapitalizimi i Fitimeve

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe në lidhje me parimet e përcaktuara në nenin 14, të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 i ndryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund të vendosë për të kapitalizuar fitimet.

TITULLI VI

SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI

NENI 16 - Prishja-Ndarja-Bashkimi

16.1 Shoqëria mund të prishet për shkak të parashikuara me ligj. Në rast të prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakëve emeron një ose më shumë likuidatore duke u përcaktuar kompetencat reciproke.

16.2 Shoqëria gjithashtu mund të ndahet ose të bashkohet me anë të një vendimi të asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve.

NENI 17 - Likuidimi

17.1 Në rast të prishjes shoqëria mund të likuidohet.

17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Zakonshme e Ortakëve emeron një ose më shumë likuidatore i cili do të hartojë raportin përfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqërisë, si dhe procedurat dhe kohën e duhur për likuidim.



17.3 Në fund të procedurave të likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakëve do të vendosë në lidhje me bilancin përfundimtar, punën e bërë nga likuiduesi dhe të përfundojë procesin e likuidimit.

17.4 Me likuidimin e kreditorëve likuiduesit gjithashtu do të shpërndajnë aktivet e mbetura të Ortakëve në proporcion me përqindjen që ata disponojnë.

TITULLI VII

NDRYSHME

NENI 18 - Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve



Fq. 8



A2021053750056711255

Çdo mosmarreveshje ose mosmarreveshjet ndermjet ortakeve ose ne mes tyre ne Shoqeri fillimisht do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe miqesisht. Nese, nje zgjidhje miqesore nuk mund te arrihet brenda 60 ditesh, çeshtja do t'i referohet Gjykatave te Tiranës, me nje proces te rregullt qe do te zhvillohet ne Tirane, Shqiperi.

NENI 19. DISPOZITA TE FUNDIT

Ky Statut dhe Akt Themelimi u hartua ne 3 (tre) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

Për sa më sipër, u hartua Statuti dhe Akti i Themelimit të shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar "PROCEDURE" SH.P.K, nga unë noterja, në prezencë të ortakut themelues të shoqërisë, bazuar në vullnetin e lirë e të plotë të tij, si dhe në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare. Pasi u lexua qartazi dhe u kuptua rëndësia dhe efektet ligjore, nënshkruhet Statuti dhe Akti i Themelimit të shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar "PROCEDURE" SH.P.K.

Akti i Themelimit dhe Statuti përbëhet nga 9 (nente) faqe dhe lëshohet në 3 (tre) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike.

Per regjistrimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti prane Qendres Kombetare te Biznesit autorizohet Flamur Baholli, atësia Isa, amësia Shaje, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me Leternjoftim ID nr. 031098397 dhe nr. personal G85708149D.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pika 1, germa "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti noterial, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

ORTAKËT THEMELUES

LIRI ÇARERI

Liri Çareri LCC

PAOLA DINAKU

Paola Dinaku

NOTERE
DENISA ÇELA